

PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar: **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019, “Për Rininë”**

2. Audiencia e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audiencia e synuar	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projektligjet	Metodat e konsultimit (e-konsultimi, takimet publike,seminare,sondazhe etj.)	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (email, rrjetet sociale, etj.)
1. Organizatat e shoqërisë civile rinore/për të rinjtë; 2. Grupet e interesit Të rinj, anëtarë të KVR-ve, KKR-së, studentë dhe punonjës rinore	(2) Konsultime për projektligjet	- Takime fizike dhe online; - Email; - E-konsultimi (REKNJKP); - Konsultime përmes platformës kahoot.	- email - Shkresa

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

Nëpërmjet Urdhrit nr.13, datë 13.11.2023, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është ngritur Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" me anëtarë nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare të Rinisë.

Janë zhvilluar aktivitete me aktorë të ndryshëm, si KKR, organizata për të rinj/rinore që synonin marrjen e inputeve për vlerësimin ex post të Ligjit 75/2019 dhe propozimeve konkrete për rishikimin e ligjeve.

Në këtë kuadër, gjatë muajit qershor 2024 u zhvillua **një workshop-i për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”**. Gjatë këtij aktiviteti u angazhuan mbi 80 përfaqësues nga institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, përfaqësuesve të organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), rinore dhe për të rinjtë, këshillit kombëtar të rinisë, këshillave vendore rinore, të organizatave rinore ombrellë, këshillave studentorë, të organizatave donatore/partnerëve

për zhvillim në sektorin e rinisë dhe ekspertëve dhe studiuesve në fushën e rinisë që u angazhuan në diskutimin e hapur dhe të strukturuar lidhur me arritjet, problematikat dhe nevojat për rishikimin e Ligjit për Rininë. Për marrjen e kontributeve në mënyrë efektive, workshop-i u konceptua në formën e katër tryezave të veçanta të punës që trajtuan aspektet e ligjit të grupuara sipas katër temave:

1. Kompetencat, funksionet dhe angazhimi i institucioneve shtetërore në fushën e rinisë.
2. Organizimi dhe veprimtaria e strukturave dhe organizatave me të rinjë.
3. Financimet për rininë
4. Krijimi i kushteve për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve.

Gjatë muajit korrik 2024, u zhvillua turi i konsultimeve me të rinjtë **“Rinia ndryshon ligjet”**, për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”. Për të lehtësuar marrjen e kontributeve nga të rinjtë u përgatitën materialet informuese dhe pyetësorët për të dy ligjet në version elektronik, të cilat ju prezantuan atyre përmes platformës Kahoot. Turi i konsultimeve u zhvillua përmes takimeve të organizuara dhe të drejtuara nga ministri i shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e grupit të punës, duke përfshirë 11 bashki të vendit dhe në një Bootcamp të dedikuar tre ditore, dhënave të tabelës së mëposhtme.

Tabela e turit të konsultimeve:

Data	Ora	Qyteti	Vendi	Nr. Pjesmarrës
1 korrik 2024	10:30 – 12:00	Kurbin	Salla e Këshillit Bashkiak	60
1 korrik 2024	14:00 – 15:30	Shkodër	Qendra Atelie	35
2 korrik 2024	11:00 – 12:30	Lushnje	Qendra Rinore	40
2 korrik 2024	14:00 – 15:30	Kucovë	Qendra Rinore	15
8 korrik 2024	12:00 – 13:30	Dibër	Qendra Rinore	20
11 korrik 2024	10:30 – 12:00	Durrës	Salla e Këshillit	20
12 KORRIK 2024	10:30 – 12:00	Librazhd	Salla e Këshillit Bashkiak	30
16 korrik 2024	10:30 – 12:00	Tiranë	Salla e Këshillit Bashkiak	40
	14:00 – 15:30	Kamëz	Qendra Rinore	50
19 korrik 2024	13:00 – 14:30	Tropojë	Salla e Këshillit Bashkiak	30
22 korrik 2024	14:30 – 15:30	Konispol	Qendra Rinore	20
29-31 korrik 2024		Tiranë	Dajt	120

2. Konsultime përmes emailit, ku aktorët e shoqërisë civile patën mundësinë të dërgonin propozimet e tyre tek anëtarët e grupit të punës.

3. Konsultime përmes REJNK, në datat 27.11.2024-25.12.2024.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>

4. Burimet e nevojshme

Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.

- *Burime njerëzore të nevojshme:*

- Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur përmes urdhrit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nr. 13, datë 13.11.2023;
- stafi i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- stafi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë;
- ekspertë të fushës, kombëtar dhe ndërkombëtar.

- *Burime Financiare të nevojshme:*

- Buxheti i shtetit
- Donator

5. Mbledhja e përgjigjeve

Përshkruani mënyrën se si mendoni që të mblidhni përgjigjet.

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

1. E-mail;
2. Shkresa/njoftime zyrtare;
3. Takime fizike dhe online;
4. Regjistri RENJK <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>;
5. Platformës kahoot.

6. Monitorimi i procesit

*Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të **përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiore dhe metodave/mjeteve që do të përdorni***

për matjen e suksesit gjatë dhe në përfundim të procesit.

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit		
Korniza e procesit	Përshatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni, si do të përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)
A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar?	☐ po ☐ jo	

A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara?		☐ po ☐ jo		
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?		☐ po ☐ jo		
Treguesit sasiorë				
Treguesit sasiorë (deklaroni treguesit për monitorim)	Vlerat e planifikuara (deklaroni treguesit për vlerat)	Vlerat e arritura (deklaroni vlerën e arritur)	Përshatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
(plotësojeni gjatë fazës së planifikimit të procesit)		(plotësojeni gjatë monitorimit)		
☐ numri i metodave të konsultimit	1. Konsultime fizike dhe online; 2. Konsultime përmes emailit; 3. Konsultime përmes REJNK; 4. Konsultime përmes platformës kahoot.		☐ po ☐ jo	
☐ numri i palëve të përfshira	1. Mbi 48 organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fusha të ndryshme kanë marrë pjesë në konsultimet fizike/online ose kanë përcjellë rekomandimet e tyre përmes postës elektronike dhe regjistrit elektronik; 2. Rreth 500 të rinj, anëtarë të KVR-ve, KKR-së, studentë dhe punonjës rinore		☐ po ☐ jo	

	kanë dhënë rekomandimeve përmes turit të konsultimeve me të rinjtë dhe takimeve të tjera.			
	3. Ekspertë të mbështetur nga projekte të UNICEF, IPA dhe UNOPS.			
X ☐ numri i pjesëmarrësve			☐ po ☐ jo	
X ☐ numri i komenteve të pranuar			☐ po ☐ jo	
☐ tjetër:			☐ po ☐ jo	
Mjetet për matjen e treguesve				
X ☐ lista e pjesëmarrësve X ☐ raportimi i aktivitetit ☐ raporti i reagimeve X ☐ lista e komenteve të marra ☐ tjetër:				
Treguesit cilësorë				
Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)		Gjetjet (deklaroni gjetet)		Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
☐ cilësia e metodave të konsultimit		Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijë synon të vijojë përdorimin e metodave të ndryshme të konsultimit si RENJK, tryezë publike apo email sidomos me qytetarë, organizata të shoqërisë civile, struktura rinore apo ekspertë të fushës. Gjithashtu, përdorimin e mjeteve për hulumtimin të		

	përshtatshme për të rinjtë si kahoot dhe google form.	
☐ përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve	Përdorimi i metodave të konsultimit do të ndikojë jo vetëm në rritjen e numrit të pjesëmarrësve, por dhe rritjen e numrit të komenteve me qëllim përmirësimin e projektligjit.	
☐ cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara	Duke zhvilluar sa më shumë tryeza konsultimi, do të rritet dhe numri i komenteve cilësore të përcjella.	
☐ treguesit sipas objektivave të procesit:		
Mjetet për matjen e treguesve		
☒ pyetësi i vlerësimit ☒ diskutimi joformal me pjesëmarrësit ☒ regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve ☒ raportimi i aktivitetit ☐ tjetër:		